

FJALA E DEPUTETIT ISUF ÇELAJ

E ENJTE 10 MARS 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Sot na është paraqitur për miratim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për rregullat e rregjimit të trafikut lokal të kufirit” Mjafton të shohësh datën e miratimit të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, për të kuptuar se sa rëndësi i ka dhënë kjo qeveri afrimit ndërmjet popujve tanë, në të dyja anët e kufirit. Miratimi i sotëm i marrëveshjes së konkluduar mbi bazën e strategjisë së mësipërme, bëhet plot 8 vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj strategjie dhe 2 vjet pas përfundimit të afatit të zbatimit konkret të dokumentit. Madje, për saktësi, strategjia në fjalë, miratuar në vitin 2014, ishte hartuar nga qeveria e mëparshme demokratike, por ky është një problem tjetër. Problemi real dhe që dhemb shumë, është se qeveria aktuale paska një strategji për menaxhimin e integruar të kufirit, por nuk ka një strategji të veçantë politike, konkrete, reale që t'u përgjigjet aspiratave për integrim ndërvete të shqiptarëve dhe kosovarëve. Është shumë pak të integrosh kufijtë tanë.

Sfida e vërtetë është integrimi ndërvete dhe në këtë drejtim ka shumë rrugë e shumë punë për t'u bërë. Dy mandate dhe me të tretin në vazhdim, janë harxhuar nga kjo qeveri për një kauzë mjaft të dyshimtë, të papërkrahur nga faktori shqipfolës, nisma e Ballkanit të Hapur. Të përpiqesh të ndërtosh një Ballkan të Hapur pa dakordësinë e mbarë faktorëve shqipfolës, do të thotë të bësh një lojë në kurriz të tyre. Ballkani i Hapur dëshmoi se ku të çon një lidhshmëri politike në shërbim vetëm të delirit dhe të egos së tij personale. Vuçiç para disa kohësh deklaroi publikisht se synohet heqja e kufijve ndërmjet vendeve tona dhe se asnjë serb nuk do të pengohet të shkonte drejt Tiranës. Kurse sot, sipas kësaj logjike, nuk do të na ngelej gjë tjetër veçse të shohim të na vijnë në Tiranë falangat nacionaliste serbe në mbështetje të Rusisë, për luftën që po i bën shtetit të pavarur të Ukrainës.

Gjej rastin këtu t'i bëj thirrje qeverisë që të bëjë përpjekjet e duhura për të mundësuar të paktën strehimin e shqiptarëve të Ukrainës në vendin tonë si detyrim human, dhe jo si detyrim sorosian në rastin e afganëve. Gjithçka reale, e vlefshme, që funksionon sot ndërmjet dy vendeve tona, mban vulën e qeverisjes së Partisë Demokratike. Nëse ju duket si propagandë kjo që po nënvizoj në këtë diskutim, ju ftoj të hapni arkivat dhe të shihni sesa marrëveshje funksionale janë nënshkruar ndërmjet dy vendeve tona në kohën e qeverisë së Partisë Demokratike dhe sa janë nënshkruar në qeverisjen tuaj. Ndryshimi dhe efikasiteti i tyre do të bënte me turp këtë qeveri. Qeveria e Partisë Demokratike dhe kryeministri i saj, Sali Berisha, ndërtoan Rrugën e Kombit, projektin më madhor kombëtar, duke çarë malet për të bashkuar shqiptarët, në antitezë me ju, që përveç se e anatemuat me lloj-lloj epitimesh e pengesash gjatë ndërtimit të saj, me ardhjen në pushtet i vendosët traun, për të ndarë shqiptarët në të dyja anët e kufirit, me tarifata e kripura të kalimit në të, edhe pse fluksi më i madh i turistëve dhe i pushuesve ditorë gjatë sezonit veror është nga Kosova. Banorët e Tropojës, Hasit e Kukësit si rrethet kufitare me Kosovën

nuk kanë vetëm lidhjen gjeografike si kufitare, por këto lidhje janë më të thella, janë lidhje gjaku dhe historie të këtyre trevave, duke luftuar për çlirimin e tyre nga pushtuesit serb, gjë e cila tregohet edhe me numrin e madh të të rënëve në fushën e betejës për lirinë e Kosovës.

Gjendjes së varfërisë ekstreme në të cilën ndodhen banorët e qarkut të Kukësit e kryesisht ata të fshatrave të zonave kufitare, i shtohet edhe rritja ekstreme e çmimeve të karburantit dhe të produkteve bazë ushqimore. Për këtë kërkohet nga të dy qeveritë respektive të liberalizojnë, me sa të ketë mundësi, procedurat burokratike doganore në të katër pikat e kontroll-kalimit doganor që kanë Tropoja, Hasi dhe Kukësi me Kosovën, meqë këto produkte janë më të lira në Kosovë, pasi qeveria atje ka marrë masa për mbështetjen e qytetarëve ndaj rritjes së këtyre çmimeve, në ndryshim nga qeveria e Rilindjes, e cila mjaftohet me thënien se çmimet i rregullon vetë tregu, ose me dhënien e këshillave si te rubrika “Trupi e shëndeti”: “Ecni në këmbë, mos përdorni automjetet”.

Megjithatë, marrëveshja e paraqitur për ratifikim mbetet hap pozitiv, por me pikatore. Jemi ende larg mundësive reale që popullatat në të dyja anët e kufirit të jenë më afër njëra-tjetrës, të solidarizohen më shumë me njëra-tjetrën, për t'u bërë ballë halleve të përbashkëta, sidomos nga ana jonë, sepse është braktisur tërësisht nga qeveria për arsye nga më të ndryshmet. Nëse kjo marrëveshje do të ishte nënshkruar 8 vjet më parë dhe nuk do të humbej kohë kot me Ballkanin e Hapur, sot do të kishim për miratim një marrëveshje tjetër, një hap tjetër, që nuk do të kishte kufizimin në qëndrim me 90 ditë në 365 ditë, por të mos kishte fare kufizim, 365 ditë në 365 ditë. Vota ime për këtë projektligj është pro, me shpresën se kjo marrëveshje do t'u shërbejë në vijim qytetarëve të të dyja anëve të kufirit. Faleminderit!